



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BASHKIA BULQIZE**  
**KESHILLI BASHKIAK**

Adresa: Lagja Minatori Bulqize tel +35521922694 email:Bashkia .Bulqize @bulqiza.gov.al

**V E N D I M**

**Nr. 12 date 24 / 02 / 2017**

**PËR**

**MIRATIMIN E FONDIT PER NDIHME FINANCIARE PER Znj. FITORE BICI:**

Bazuar ne ligjin Nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" ne ligjin nr.9936,date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit ne Republiken e Shqiperise" ne ligjin nr.10487,date 05.12.2011" Per Buxhetin e Shtetiti 2012" si dhe ne zbatim te ligjit 10296,date 08.07.2010 Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" si dhe Udhezimin nr.30,date 27.12.2011 "Per Menaxhimin e Akteve dhe mjeteve Monetare ne Njesine e Sektorit Puplik",**Keshillit Bashkiak ne mledhjen e tij te dates 24.02.2017 pasi diskutoi dhe analizoi rreth projektit te paraqitur nga Drejtoria e Sherbimit Social dhe Drejtoria e Finances ne ne Bashki me 14 vota pro, asnje kunder dhe asnje abstenim:**

**V E N D O S I:**

1-Te miratoje nje fond prej 30.000 leke per ti dhene ndihme financiare Znj. Fitore Bici nga fondi i akorduar nga projekti Pnud (Program Kombeve te Bashkuara per Zhvillim) si fond i planifikuar per raste specifike te dhunes ne familje:

Raport mbi situaten social-ekonomike te Znj.Fitore Bici

Emer Mbiemer	Fitore Jashar Bici
Statusi Civil	E martuar
Vendlindja	Smollik -Bulqize
Vendbanimi meparshem	Strican
Vendbanimi aktual	Durres
Datelindja	09.02.1979
Arsimimi	Fillor
Profesioni	Nuk ka profesion
Statusi I punesimit	E pa pune
Numi I femijeve	4

Fitore Bici perbehet nga 6 anetare familje, Fisnik Bici bashkeshorti, Fitore Bici bashkeshortja dhe 4 femijet e tyre. Familja Bici ka jetuar per shume vite ne Strikcan te njesise administrative Zerqa te Bashkise Bulqize. Bashkeshorti I saj ka ushtruar dhune mbi gruan e tij Fitoren dhe femijet e saj per shume vite, Si pasoje e ketyre problemeve Fitorja pesoi depression dhe per kete ajo perfiton pagese te paaftesise ne Shumen 10140 mije leke te reja. Fitorja eshte ankuar ne bashki ne zyren e sherbimit social se kercenohej nga bashkeshorti. Ai po krynte denimin me burg dhe kercenonte Fitoren dhe djalin e madh Mikelin kur ata shkonin ta vizitonin ne burg. Duke qene se bashkeshortit te saj I kishte mbetur dhe nje muaj burg dhe do lirohej Fitorja vendos te shperngulet ne Durres bashke me femijet e saj duke marre nje shtepi me qera pasi nuk mund te duronte me dhunen e burrit te saj dhe alkolizimin e tij. Situata aktuale e saj eshte e veshtire pasi eshte e pa pune, djali po ashtu, dhe ajo kerkon ndihme nga Bashkia Bulqize per te perballuar qerane e shtepise pasi nuk ka mundesi ta paguaje. Gjithashtu ndihma do te sherbeje edhe per nevoja kryesore si ushqim dhe veshje. Per kete Keshilli I Bashkise mori vendim qe znj Fitore Bici ti jape ndihme financiare ne Shumen 30.000 (tridhjete mije) leke te reja.

2- Ky vendim hyn ne fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Diber.

#### PER KESHILLIN BASHKIAK

SEKRETARI  
Agim TUCI



KRYETARI  
Gazmend KENGA

